



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr.115, Datë 27.07.2015

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me Nr. Regj. 100, datë 04.11.2014, të paraqitur nga znj. _____ undër subjektit Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

Znj. _____ është diplomuar në vitin 2008, në Universitetin Amerikan të Bullgarisë, në Bullgari, me program 4-vjeçar, në Ekonomiks me profile në Shkenca Kompjuterike dhe Sisteme Informacioni. Me shkresën me nr. Regj. 147, datë 25.03.2014, Komisioni i Njohjes së Diplomave, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit ka bërë vërtetimin e njohjes dhe njësimit, duke e njësuar si Bachelor në Republikën e Shqipërisë. Me anë të shkresës me datë 20.10.2014, të _____ me detyrë Sekretar i Përgjithshëm në Drejtorinë e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, i bëhet me dije znj.Stefa se: “... diploma e saj është një diplomë universitare që i përket ciklit të parë të studimeve, prandaj është njësuar si “Bachelor”. Po kështu vetë emërtimi i diplomës në përmbajtjen e saj është “Bachelor of Arts” dhe nuk i përket ciklit të dytë të studimeve Master”.

etendon se ka një Urdhër të posaçëm të Ministisë së Arsimit dhe Sportit, sipas të cilit, diplomat e Universitetit të Neë Yorkut në Tiranë njihen si Master Profesional. Ankuesja pretendon se diplomat e lëshuara në Shqipëri në vitin 2008, vit në të cilin është diplomuar edhe ajo, njihen si Master Shkencor i nivelit të dytë. Znj.Stefa pretendon se është trajtuar në mënyrë të



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

pabarabartë me studentët që janë diplomuar brenda Shqipërisë, për faktin se diploma e saj është e huaj dhe është lëshuar nga Institucione amerikane jashtë Republikës së Shqipërisë.

Ankuesi kërkon nga ana e Komisionerit që në zbatim të ligjit nr. 10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", t'i rekomandojë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit njohjen e diplomës së saj si "Master".

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: "*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*".

Neni 3, pika 1 i po këtij ligji, shpreh se: "*Diskriminimi*" është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Në nenin 7 të ligjit nr. 10 221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën Nr.946/1 prot, datë 10.11.2014 u njoftua dhe ju kërkuar informacion subjektivit Ministria e Arsimit dhe e Sportit, duke e vënë në dijeni për fillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesës si dhe duke i kërkuar informacion mbi pretendimin e ngritur nga znj. Stefa. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminiminuk pati asnjë përgjigje zyrtare në afatet e përcaktuara nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i cili në nenin 33, pika 7, thotë se: ... Komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita që palët marrin njoftim,
2. Me datë 16.01.2015, në zbatim të Urdhërit nr. 2, datë 08.01.2015, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim në ambjentet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
Inspektorët e KMD-së u takuan me znj. [] me pozicion Përgjegjëse e Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Njohjes së Diplomave, pranë kësaj ministrie. [] për shkak se ishte njohur me vonesë me Urdhërin e inspektimit të Komisionerit, kërkoi një afat për përgatitjen e përgjigjes dhe dërgimin e saj deri më datë 31.01.2015.
3. Me shkresën me nr. 150/1 prot., datë 29.01.2015, Ministria e Arsimit dhe e Sportit, lidhur me çështjen e [] n me dije se:
 - A. Komisioni i Njohjes së Diplomave në mbledhjen e datës 25.03.2014, mori në shqyrtim dokumentacionin e aplikimit të znj. [] vendosur njohjen e diplomës universitare dhe njësimin e saj si “Bachelor” në Republikën e Shqipërisë.
 - B. Me datë 31.07.2014 znj.Stefa ka depozituar një ankesë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit mbi njësimin e diplomës së sipërcituar, për të cilën i është kthyer përgjigje me shkresën me nr. 2/1172/1, datë 20.10.2014.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

- C. Lidhur me pretendimim e ankueses se diplomat "Bachelor of Arts" të Universitetit të Neë Yorkut në Tiranë njihen si "Master Profesional", në shkresë bëhet me dije fakti se: "Ky Universitet është një institucion privat i arsimit të lartë dhe ushtron aktivitetin si i tillë në Republikën e Shqipërisë. Programet e ofruara nga ky institucion i nënshtrohen procesit të akreditimit si të gjithë programet e studimit të ofruara nga institucionet e tjera të arsimit të lartë në Shqipëri. Për rrjedhojë, diplomat e lëshuara nga ky institucion i arsimit të lartë nuk i nënshtrohen procesit të njohjes siç ndodh me diplomat e huaja".
- D. Janë sjellë dy raste të ngjashme të njësimit të diplomave të dy studentëve që kanë mbaruar studimet në të njëjtin universitet me ankuesen, dhe respektivisht:
1. diplomuar në vitin 2008, në "Gazetari dhe Komunikim të Masmedia", me program 4-vjeçar, pranë Universitetit Amerikan në Bullgari, diplomë e njësuar si "Bachelor" në Republikën e Shqipërisë, më datë 13.06.2014, nga Komisioni i Njohjes së Diplomave, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
 2. diplomuar në vitin 2007, në "Matematikë dhe Shkenca Kompjuterike", me profil në Ekonomiks, me program 4-vjeçar, pranë Universitetit Amerikan në Bullgari, diplomë e njësuar si "Bachelor" në Republikën e Shqipërisë, më datë 31.12.2014, nga Komisioni i Njohjes së Diplomave, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
4. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes së znj.Stefa, Komisioneri me datë 16.02.2015 realizoi një seancë dëgjimore mes palëve.
- Ministria e Arsimit dhe Sportit u përfaqësua në seancën dëgjimore nga me pozicion Përgjegjëse e Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Njohjes së Diplomave, pranë kësaj ministrie, si person i autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm, për të përfaqësuar këtë Institucion, me shkresën me nr. 1101/1 Prot., datë 13.02.2015.
- ksoi faktin që Universiteti i Neë Yorkut njihet si universitet shqiptar privat dhe i ka të përshtatur programet sipas legjislacionit shqiptar. Për rrjedhojë, diplomat e lëshuara nga ky universitet nuk njësohen, por trajtohen si si të gjitha diplomat e marra në universitetet shtetërore dhe private shqiptare.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
 (Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
 Tel: +355 4 2431078
 Fax: +355 4 2431077
 e-mail: info@kmd.al
 web: www.kmd.al

igriti pretendimin se është vepruar ndryshe për njësimin e diplomave të dy studentëve të tjerë. Për këtë arsye, ... si detyrë të verifikonte dhe të sillte kopje të procedurës së ndjekur për secilin rast: 1. Për njësimin e diplomës së ... 2. Për njësimin e diplomës së ...

5. Duke mos patur një përgjigje zyrtare në afatet e përcaktuara nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, lidhur me plotësimin e informacionit të kërkuar gjatë seancës dëgjimore të datës 16.02.2015, me shkresën me nr. 280 Prot., datë 23.03.2015, Komisioneri iu drejtua sërish Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për dërgimin e këtij informacioni.

Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresën me nr. 2497 prot., datë 25.03.2015, bën me dije se:...” *Komisioni i Njohjes së Diplomave, i cili ka marrë në shqyrtim dosjet e shtetasve të sipërcituar (J.GJ dhe E.M), i trajtonte dhe i vlerësonte diplomat e huaja, rast pas rasti, sipas kriterit të vlerësimit të diplomave të lëshuara në Republikën e Shqipërisë. Personat e sipërcituar janë diplomuar në të njëjtin universitet me ankuesen dhe kanë përfunduar studimet me programin 4-vjeçar të studimeve, të njohura si “bachelor” në universitetin e origjinës, njëjloj si ajo.*

Ndërkohë që, Komisioni aktual i Njohjes së Diplomave përcakton nivelin e diplomave të huaja të depozituara për njohje dhe njësimit në të njëjtin nivel si në vendin e origjinës, pra një diplomë universitare e ciklit të parë, njësohet si një diplomë universitare e ciklit të parë “Bachelor”. Në rastet kur niveli nuk është qartësisht i përcaktuar në diplomën universitare përkatëse, specialistët e Sekretariatit të Njohjes së Diplomave i drejtohen zyrës përkatëse të njohjes së diplomave dhe informimit në vendin e origjinës (Rrjeti ENIC NARIC), për të përcaktuar nivelin e diplomës sipas kornizës kombëtare dhe evropiane të kualifikimeve, ose universitetit përkatës.”.

Pas vlerësimit të fakteve dhe provave të grumbulluara gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri vlerëson se:

- I. **Lidhur me pretendimin e ... është trajtuar në mënyrë të pabarabartë me studentët e tjerë që janë diplomuar në Universitetin e Neë Yorkut në Tiranë, në procedurën e njohjes së diplomës.**

- i. **Krahasuar me studentët e diplomuar në Universitetin e Neë Yorkut në Tiranë.**



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Ky Universitet është një institucion privat i arsimit të lartë dhe ushtron aktivitetin si i tillë në Republikën e Shqipërisë. Programet e ofruara nga ky institucion i nënshtrohen procesit të akreditimit si të gjithë programet e studimit të ofruara nga institucionet e tjera të arsimit të lartë në Shqipëri. Për rrjedhojë, diplomat e lëshuara nga ky institucion i arsimit të lartë nuk i nënshtrohen procesit të njohjes siç ndodh me diplomat e huaja.

Komisioneri shqyrton ankesën në zbatim të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi", dhe bën verifikimet nëse në kundërshtim me këtë ligj kemi trajtim të ndryshëm në kushte të njëjta të ankuesit krahasuar me persona të tjerë, apo trajtim më pak të favorshëm të tij, për një nga shkaqet e parashikuara në këtë ligj.

Pretendimi i ankueses se është trajtuar ndryshe nga studentët e Universitetit të Neë Yorkut në Tiranë, nuk qëndron, pasi, Komisioneri, konstaton se nuk mund të bëhet një krahasim i tillë, për arsye se, Universiteti i Neë Yorkut në Tiranë, është një institucion privat i arsimit të lartë dhe ushtron aktivitetin si i tillë në Republikën e Shqipërisë. Diplomate e lëshuara nga ky institucion i arsimit të lartë nuk i nënshtrohen procesit të njohjes siç ndodh me diplomate huaja.

ii. Krahasuar me studentët e diplomuar në Universitetin Amerikan, në Bullgari.

Nga aktet shkresore të vëna në dispozicion nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, rezulton se, njësimi i diplomave të z. J.G.J., është bërë si më poshtëcitet:

- a) Referuar dokumentit Dëshmi për njohje diplomimi, me nr. Regj. 5702, datë 23.11.2011, si dhe procesverbalit të mbajtur po me këtë datë, nga Komisioni i Njohjes së Diplomave, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, është bërë njohja e diplomës së z. J.G.J, lëshuar nga Universiteti Amerikan, Bullgari, me program 4-vjeçar si Master Profesional në Shkenca Kompjuterike dhe Administrim Biznesi.
- b) Referuar dokumentit Dëshmi për njohje diplomimi, me nr. Regj. 1533, datë 13.12.2012, si dhe procesverbalit të mbajtur po me këtë datë, nga Komisioni i Njohjes së Diplomave, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, është bërë njohja e diplomës së z. J.G.J, lëshuar nga Universiteti Amerikan, Bullgari, me program 4-vjeçar si Master i Shkencave në Administrim Biznesi, Gazetari dhe Komunikim i Masmedias.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Sa më sipër, Komisioneri konstaton se në dokumentin për vërtetimin e njohjes dhe njësimit të diplomave të të pesë studentëve ¹, të gjithë të diplomuar në Universitetin Amerikan të Bullgarisë, nga ana e Komisioneve për Njohjen e Diplomave, është përdorur e njëjta bazë ligjore: neni 37 i ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Udhëzimi nr. 41, datë 08.12.2009, “Për procedurat dhe kriteret e njohjes së diplomave dhe certifikatave të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë”, i ndryshuar.

Neni 3, i ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikon se: “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

Sa më sipër, rezulton se, znj.

1. megjithëse ka mbaruar të njëjtin universitet të huaj me : 'he zi
 2. megjithëse në diplomat e marra prej tyre nga i njëjti institucion i huaj i arsimit të lartë, citohet se të katërt kanë mbaruar programin 4-vjeçar të studimeve,
 3. megjithëse nga ana e Komisionit të Njohjes së Diplomave, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, është përdorur e njëjta bazë ligjore,
- asaj i njihet diploma si “Bachelor”, ndërkohë që J.GJ, i njihet si “Master Profesional” dhe E.M, si “Master i Shkencave”.

Pra, znj. është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme se sa dy personat sipërcituar, në të njëjtën situatë, gjë që në interpretim të nenit 3, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, e vë ankuesen në pozitat e diskriminimit të drejtpërdrejtë nga ana e Komisionit të Njohjes së Diplomave, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

II. Lidhur me argumentet e MAS.

1. Për pretendimin se është trajtuar ndryshe, lidhur me studentët që janë diplomuar në Universitetin Amerikan, Bullgari, Komisioneri, konstaton se:

¹ 1. I.S, 2. J.GJ, 3. E.M, 4. G.B, 5. F.B



- 1.1 Referuar dokumentit Dëshmi për njohje diplomimi, me nr. Regj. 147, datë 25.03.2014, si dhe procesverbalit të mbajtur po me këtë datë, nga Komisioni i Njohjes së Diplomave, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, është bërë njohja e diplomës së znj. lëshuar nga Universiteti Amerikan, Bullgari, me program 4-vjeçar si Bachelor në Ekonomiks, me profile në Shkenca Kompjuterike dhe Sisteme Informacioni.
- 1.2 Referuar dokumentit Dëshmi për njohje diplomimi, me nr. Regj.5702, datë 23.11.2011, si dhe procesverbalit të mbajtur po me këtë datë, nga Komisioni i Njohjes së Diplomave, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, është bërë njohja e diplomës së z. lëshuar nga Universiteti Amerikan, Bullgari, me program 4-vjeçar si Master Profesional në Shkenca Kompjuterike dhe Administrim Biznesi.
- 1.3 Referuar dokumentit Dëshmi për njohje diplomimi, me nr. Regj. 1533, datë 13.12.2012, si dhe procesverbalit të mbajtur po me këtë datë, nga Komisioni i Njohjes së Diplomave, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, është bërë njohja e diplomës së znj. lëshuar nga Universiteti Amerikan, Bullgari, me program 4-vjeçar si Master i Shkencave në Administrim Biznesi, Gazetari dhe Komunikim i Masmedias.
- 1.4 Njësimi i dy diplomave të marra si rast krahasues, është bërë rast pas rasti, dhe nga verifikimi i procesverbalëve të mbajtur nga Komisioni rezulton që ato kanë të njëjtat pikë kreditesh me ankuesen.
- 1.5 Njësimin e diplomës së ankueses, Komisioni e ka bërë si në vendin e origjinës. Pra, në këtë rast ka përdorur një kriter tjetër, të ndryshëm, të pambështetur ligjërisht, bazuar në diskrecionin e tij, si komision. Baza ligjore e cituar në të gjithë dokumentet, njësimit diplome, sipërcituar, është e njëjtë.
- 1.6 Ministria e Arsimit dhe e Sportit, në komunikimin shkresor me Komisionerin, nuk ka paraqitur asnjë argumentim të bazuar ligjërisht se përse, njëri Komision i ka bërë njësimit e diplomave rast pas rasti, dhe një Komision tjetër, i ka njësuar si në vendin e origjinës.
- 1.7 Të pyetur nëse janë bazuar në një dispozitë të caktuar ligjore, apo rregullore që përcakton mënyrën se ku bazohet Komisioni për njësimin e diplomave të huaja, Ministria, bën me dije se është e njëjta bazë ligjore e cituar në aktin e njësimit të diplomës.
- 1.8 Referuar shkresës me nr. 280 Prot., datë 23.03.2015, Ministria e Arsimit dhe Sportit, nuk jep një shkak të argumentuar se përse znj.Stefa është trajtuar ndryshe në procesin e



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
 (Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
 Tel: +355 4 2431078
 Fax: +355 4 2431077
 e-mail: info@kmd.al
 web: www.kmd.al

njohejs së diplomës. Nga arsyetimi i bërë në shkresën e saj, Ministria e lë në diskrecion të Komisionit të Njohjes së Diplomave, njësimin e tyre.

PËR KËTO ARSYE :

Në bazë të nenit 32, gërma “c”, si dhe nenit 33, pikat 10, 11 dhe 12, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë të znj. _____ nga ana e Komisionit të Njohjes së Diplomave, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
2. Ministria e Arsimit dhe Sportit, (Komisioni për Njohjen e Diplomave), si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, ndaj znj. _____ rekomandohet të shqyrtojë rishtaz vendimin lidhur me njohjen e diplomës së ankueses.
3. MAS të realizojë verifikimin e praktikave qartazi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Ministria e Arsimit dhe Sportit, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
5. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë.



Irma BARAKU

KOMISIONERI

Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
 (Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
 Tel: +355 4 2431078
 Fax: +355 4 2431077
 e-mail: info@kmd.al
 web: www.kmd.al